



SYLLABUSI

Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta penale – pjesa e posaçme
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II, semestri IV
Numri i orëve në javë:	3 +1
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha/ lokacioni:	E enjte, gr. III- 9:30-11:45; gr. IV – 12:00 – 14:15;
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Assoc. Dr Vedije Ratkoceri
Detajet kontaktuese:	vedije.ratkoceri@uni-pr.edu v.ratkoceri@seeu.edu.mk
Përshkrimi i lëndës:	Ky semester do t’i dedikohet mësimi të së drejtës penale materiale - pjesa e posaçme ku studentët do ta kuptojnë logjikën e funksionimit të pjesës së posaçme të Kodit Penal si bazë e materies penale e cila më tej zhvillohet në procedurën penale dhe gjatë ekzekutimit të sanksioneve. Studentët do të krijojnë kuptim mbi tri elementet kryesore të të drejtës penale materiale edhe atë: vepra penale, kryerësi i veprës penale dhe sanksioni penal, në mënyrë konkrete për grupe të veçanta të veprave penale. Studentët do të analizojnë dhe do ta implementojnë

	gjatë studimit të rasteve Kodin penal të Republikës së Kosovës duke trajtuar në veçanti pjesën e posaçme të tij.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me pjesën e posaçme të së drejtës penale si e drejtë pozitive në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj lënde, studentët do të mësojnë për veprat penale konkrete sipas sistemit ligjor të Republikës së Kosovës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - Të bëjnë dallimet themelore dhe substanciale mes veprave të ndryshme penale dhe të kuptojnë ndërlidhjen si dhe funksionimin e tyre në praktikë; - Të bëjnë dallimet e duhura teorike dhe praktike të nocioneve, kuptimeve dhe dukurive që lidhen me veprat e posaçme penale; - Të shpjegojnë dhe analizojnë proceset e ndryshme që kanë të bëjnë me pjesën e posaçme të së drejtës penale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15 javë	15
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15 javë	15
Ushtrime në teren	/	/	/

Kollokfiume,seminare	2	ditë	2
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/
Përgatitja përfundimtare për provim	4	javë	60
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	javë	30
Projektet,prezentimet ,etj	/	/	/
Totali	15	15 javë	167 orë

Metodologjia e mësimdhënies:

Në këtë lëndë studentët do të ndjekin tre orë akademike ligjërata dhe një orë akademike ushtrime në javë. Ligjëratat do të realizohen në mënyrë interaktive ku studentët do të kenë një rol shumë të rëndësishëm. Përveç prezantimeve të ligjërueses, ku studentët do të jenë të kyçur në mënyrë direkte përmes pyetjeve dhe komenteve eventuale rreth temës, studentët do të marrin pjesë edhe në debatim dhe argumentim në kuadër të pjesëmarrjes së tyre aktive në mësim. Gjithashtu, aktiviteti i studentëve në ligjërata do të vlerësohet edhe përmes kuizeve në platformën Google Classroom.

Metodat e vlerësimit:

Përshkrimi i përgjithshëm i vlerësimit i shprehur në përqindje:

Vijueshmëria dhe aktiviteti në ligjerata	10
Vijueshmëria dhe aktiviteti në ushtrime	10
Kolokfiumi i parë	30
Kolokfiumi i dytë	50
Totali	100

Përshkrimi i sistemit të notimit:

Nota	ECTS nota	Pikë	Përkufizimi
10	A	91-100%	Shkëlqyeshëm
9	B	81-90%	Shumë mirë
8	C	71-80%	Mirë
7	D	61-70%	Kënaqshëm
6	E	51-60%	Mjafton
5*	FX	40-50%	Dobët
5	F	00-39%	Dobët

LITERATURA	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Ismet Salihu: E drejta penale – pjesa e posaçme, Prishtinë 2021 - Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Komentari i Kodit Penal të Kosovës-Pjesa e përgjithshme</i>, grup autorësh, botimi 2013; - Dressler and Garvey, <u>Cases and Materials on Criminal Law</u> 9th ed. (West) ISBN-13: 9781636596891 - ELLEN S. PODGOR ET AL., <u>CRIMINAL LAW: CONCEPTS AND PRACTICE</u> (4th ed. 2018, Carolina Academic Press) - Brody, D. & Acker, J. (2015). <u>Criminal Law</u> (3rd Ed). Jones & Bartlett Publishers - Giovanni Fiandaca, Enzo Musco: <u>Diritto penale (Parte generale)</u>, Bologna, 2010. - Dressler Joshua: <u>Understanding criminal law</u>, Cecondedition, New York, 1995. - Jean Pradel, Geert Corstens dhe Gert Vermuelen, <u>Droit penal europeen</u>, Dalloz, 2009.
LIGJERATAT	
JAVA	Temat që do të zhvillohen:
Java I 20.02.2025	<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri rreth sillabusit dhe kërkesave të lëndës - Vështrime të përgjithshme rreth pjesës së posaçme të së drejtës penale
Java II 27.02.2025	<ul style="list-style-type: none"> - Nocioni, lënda dhe metodat e studimit të pjesës së posaçme të së drejtës penale - Raporti i pjesës së përgjithshme me pjesën e posaçme të së drejtës penale - Sistemi i pjesës së posaçme të së drejtës penale
Java III 06.03.2025	<ul style="list-style-type: none"> - Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës
Java IV 13.03.2025	<ul style="list-style-type: none"> - Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare
Java V 20.03.2025	<ul style="list-style-type: none"> - Veprat penale kundër jetës dhe trupit
Java VI 27.03.2025	<ul style="list-style-type: none"> - Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut - Veprat penale kundër të drejtave të votimit

	- Veprat penale kundër marrëdhënive të punës
Java VII 03.04.2025	Kolokfiumi i parë
Java VIII 10.04.2025	- Veprat penale kundër integritetit seksual - Veprat penale kundër martesës dhe familjes
Java IX 17.04.2025	- Veprat penale kundër shëndetit publik - Veprat penale të narkotikëve - Krimi i organizuar
Java X 24.04.2025	- Veprat penale kundër ekonomisë
Java XI 01.05.2025	- Veprat penale kundër pasurisë
Java XII 08.05.2025	- Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore - Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë
Java XIII 15.05.2025	- Veprat penale të armëve - Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik - Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë
Java IX 22.05.2025	- Veprat penale kundër rendit publik - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare
Java XV 29.05.2025	Kolokfiumi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjërata dhe inkurajohen të jenë aktiv me pyetje dhe diskutime rreth tematikave të lëndës;
- Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e detyrueshme dhe shumë e rëndësishme për të realizuar qëllimin e lëndës/programit;
- Ligjëratat dhe vlerësimi do të jetë në pajtim me programin dhe informimin paraprak të studentëve.
- Sjellja në pajtim me rregulloren dhe standardet etike të përcaktuara nga universiteti.
- Studentët dhe mësimdhënësit duhet të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik.